



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
Zv.KRYETARI

Nr. 1151 Prot

Pukë, më. 07.07.2025

URDHËR

Nr. 194, datë 07/07/2025

PËR EMËRIMIN E KOORDINATORIT TË PERFORMANCËS SË BASHKISË PUKË

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Vendimit nr.227, datë 09.04.2024 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore", si dhe Udhëzimeve të Ministrit përgjegjës për pushtetin vendor dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV), në kuadër të sistemit të matjes dhe vlerësimit të performancës së bashkive dhe nevojës për garantimin e koordinimit institucional në procesin e matjes dhe raportimit të performancës vendore,

URDHËROJ:

1. Z.Ferit Ringaj me detyrë Zv.Kryetar i Bashkisë emërohet Koordinator i Performancës për Bashkinë Pukë.

2. Koordinator i Performancës ngarkohet me detyrën:

a- Të mbledhë dhe sistemojë të dhënat mbi treguesit e performancës në përputhje me kërkesat e AMVV-së;

b- Të bashkëpunojë me strukturat përkatëse brenda Bashkisë dhe me institucionet qendrore për raportimin zyrtar;

c- Të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike vendore.

3. Koordinator i Performancës dhe strukturat përkatëse të Bashkisë (drejtori, sektorë, institucione të varësisë), ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Rrok DODAJ

